Konkluzione

Zhvillimi i fëmijërisë së hershme në Shqipëri shihet kryesisht si rezultat i ndërhyrjes së familjes dhe pastaj i punës që bëjnë çerdhet, kopshtet, jetimoret, etj. Ndërhyrja e familjes për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve bazohet në një sistem besimesh e praktikash të trashëguara, ndërsa ndërhyrja e institucionecve publike e jopublike bazohet në politika të shpallura. Mirëqenia dhe edukimi i fëmijëve 0-6 vjeçarë duket se kushtëzohet më shumë nga ndikimi i besimeve e praktikave që gjallojnë në familje sesa nga ndërhyrja e planifikuar institucionale.

Sistemi i besimeve e praktikave, poashtu si edhe politikat institucionale përmbajnë elementë miks, me ndikim kontradiktor në rritjen dhe në edukimin e fëmijëve.

4.1. Besime e praktika tradicionale familjare me kah pozitiv

- *Vlerësimi i lartë i prezencës së fëmijës në përbërjen e familjes që sendërtohet në dashuri dhe përkushtim*. Vlerësimi që në fillim i fëmijëve duket se shërben si një shtrat mbi të cilin ndërtohen pozitivitete të tjera të rëndësishme. E zhvilluar në ekstrem kjo mund të çojë edhe në sakrifica të panevojshme për fëmijët, megjithatë pasojë ekëtij vlerësimi duket se është kujdesi për ushqimin, shëndetin, etj., që janë gjëra jetike.

- *Vlerësimi i lartë dhe praktikimi i ushqyerjes me gji në përqindje të larta në gjashtë muajt e parë dhe më tej*. Në vijim të kësaj, pranë natyrës ose me kujtimet e saj, shqiptarët kanë një qëndrim shumë të lartë vlerësues për bulmetin, posaçërisht për qumështin e lopës. Qumështi i gjirit dhe më vonë ai i lopës duket se hedhin themelet e një shëndeti të mëvonshëm.

- *Kontakti i madh fizik mes nënës e fëmijës*. Figura kryesore për fëmijën 0-6 vjeç është nëna dheme të fëmijët janë të lidhur fizikisht e jofizikisht. Lidhjet fizike me nënat zhvillojnë edhe lidhje shpirtërore si atashime të sigurta, vetbesim, siguri, dinjitet.

- *Stimulimi i madh motorik*. Kontaktimi fizik i fëmijëve dhe lejimi i gjallërisë e i lojës së tyre nga të rriturit, vlerësimi i lartë i shkathtësisë bëjnë që fëmijët të rriten në mjedise me shanse për atashime të sigurta dhe në klimë kërkesash për gjallëri.

- *Stimulimi i hershëm psikosocial*. Ekziston një qëndrim i përgjithshëm lejues për angazhimet e fëmijëve. Ndër to angazhimi me punë në fshat dhe komunikimet e zgjeruara në qytete i fusin fëmijët herët në botën e punës e të interaksioneve me të tjerët, angazhime me një efekt zhvillues të njohur psikosocial.

- *Ekzistenca e një sistemi të gjerë natyror kujdesi*. Krahas nënës që që merret me gjithçka që nevojitet për të rritur e edukuar një fëmijë ndihmojnë edhe të tjerë. Nëna shqiptare merr një mbështetje të rëndësishme në gjithë këtë punë në radhë të parë nga pjesa femërore e familjes ose/dhe nga familja e origjinës. Kjo vjen në vijim të

ekzistencës së lidhjeve të forta fisnore. Rezultat i kësaj është se fëmijët shqiptarë rriten mes njërëzve të familjes dhe të afërmve, gjë që përbën një sistem të gjerë suporti.

4.2. Besime e praktika tradicionale familjare me kah negativ

- *Kërkesa e theksuar se i mituri duhet t'i bindet të rriturit*. Shoqëria shqiptare është një shoqëri me një hierarki të njohur moshore: për eksperiencën vlerësohet me përparësi i rrituri, ndërsa për nevojat i mituri. Eshtë mbizotëruese se që të ndodhë gjithmonë kështu të vegjlit duhet të binden, të nënshtrohen, të mos kundërshtojnë të rriturit. Në këtë klimë socializohen që herët edhe fëmijët 0-6 vjeçarë. Nuk dihet se ç'mund të ndodhë më vonë kur këta fëmijë të kenë kapacitetin e duhur për të rebeluar. Nënvleftësimi i të drejtave të fëmijëve fillon kështu shumë herët në jetë.

- *Përdorimi i formave ekstreme të ndëshkimit*. Besohet se ndëshkimi është me veti të mëdha edukuese dhe prej këtij besimi vjen përdorimi i shpeshtë i ndëshkimeve dhe, disa herë, edhe i formave ekstreme të tyre. Tepërimi me ndëshkime të ashpra verbale e joverbale e tensionon klimën ku rriten fëmijët dhe i traumatizon ata duke u dhënë atyre modele sjelljesh agresive.

- *Preferenca për adaptime brenda lidhjeve të gjakut*. Shqiptari e do shtëpinëme fëmijë dhe fatkeqësia është kur ai nuk i ka ata: martesa si rregull prishet. Adaptimi shihet si zgjidhje e problemit pas shumë dhimbjesh e hezitimesh. Preferohen fëmijët e të afërmve dhe kjo lehtëson sepse në familje nuk ka hyrë një i huaj, se marrëveshja dhënës-marrës do të respektohet, se gjenetika e tij dihet. Ky mentalitet kontribuon në ruajtjen e përbuzjes ndaj të adaptuarve dhe në vështirësinë për të gjetur familjë për ata që nuk e kanë.

- *Fajësimi i gruas për sterilitetin*. Shoqëria shqiptare është një shoqëri ku besimet e praktikat maskiliste janë mjaft virulente. Fajësimi i grave si sterile për të shpëtuar reputacionin e burrave i vë në pozita poshtëruese femrat dhe ato humbasin nga kapaciteti i tyre për të qenë të lira.

- *Mospërdorimi në masë i kontraceptivëve*. Mosnjohja dhe mospërdorimi i kontracetivëve sjell si pasojë shtatzani të padëshiruara, familje numeroze, rreziqe për shëndetin e grave, distanca të pafavorshme nga njera lindje në tjetrën, pamundësi për t'u ofruar fëmijëve kushtet optimale të mundura për rritje e zhvillim.

- *Mbingarkesa me punë e gruas shtatzanë*. Megjithëse besohet se ndaj gruas shtatzanë duhet treguar një klujdes më i madh, ajo praktikisht mbetet përsëri e mbingarkuar me punë. Këto mbingarkesa që sjellin komplikacione të dukshme e të padukshme për shëndetin e saj dhe të bebit të ardhshëm, nënvleftësohen.

- *Përdorimi i mjekimeve popullore dhe i ritualeve fetare për nevojat e shëndetit*. Kjo kryhet gjer në masën që vështirëson kurimin dhe rrezikon jetën e nënës dhe të bebit. Prindërit kujdesen për shëndetin e grave shtatzana e të fëmijëve dhe në këtë drejtim ata kanë mënyra popullore për ta trajtuar shëndetin e tyre, por kjo praktikë jo rrallë i shtyn

prindërit e familjeve të varfëra t'i dërgojnë shumë vonë te doktori fëmijët, dhe disa herë ndërhyrja mjekësore rezulton e vonuar.

- *Turpi për të folur e trajtuar problemet e konceptimit, seksualitetit*. Në zonat fshatare sidomos, ekziston një turp për të ekspozuar shtatzaninë e për t'u vizituar te gjinekologu. Pasojat e dëmshme të një qëndrimi të tillë i vuajnë nënë e bir.

- *Njëanshmëria e ushqyerjes me bazë qumështi*. Vlerësimi i bulmetit për ndërtimin e një organizmi të shëndoshë dhe mbrojtjen nga sëmundjet, siç u përmend, në kushtet e varfërisë dhe të mungesave në informim, çon në dieta të varfëra e në rritje të sëmundshmërisë së fëmijëve.

- *Diferencimi i hershëm gjinor*. Besimet mbi nevojën e diferencimit gjinor dhe praktikat përkatëse gjejnë një përhapje mjaft të gjerë. Ato ngurtësojnë rolet tradicionale të femrave e të meshkujve duke ruajtur të paprekur pozitën inferiore të femrave. Shprehjet e shumanshme të këtij diferencimi dëmtojnë rëndë të drejtat e fëmijëve të gjinisë femërore dhe liritë e tyre për të zhvilluar gjithanshmërisht potencialet që kanë. Kështu vajzat gëzojnë që herët një status më të ulët se ai i vëllezërve të tyre, gjë që ka koston e vet në zhvillimin mbarëshoqëror.

- *Aktivizimi i paktë i baballarëve në rritjen dhe edukimin e fëmijëve*. Pavarësisht se është i justifikuar me angazhimin me punë jashtë shtëpie, kontributi anësor i baballarëve në rritjen dhe edukimin e fëmijëve, në thelb përbën një reduktim të detyruar të kapacitetit të familjes për të rritur fëmijë të shëndetshëm e të kompletuar. Kufizimi i angazhimit të baballarëve kryesisht në role argëtuese e disiplinuese përbën një mangësi. Mangësitë në identifikimin me figurat mashkullore dihet se shpien në identifikime të deformuara.

- *Nënvleftësimi i kapacitietit nxënës të fëmijëve*. Mentalitet dukshëm mbizoterues është se jeta e vërtetë e njeriut fillon më vonë, kur fillon shkolla ose puna, ndërsa vitet e hershme janë sinonim i lojës, i kalamallëqeve. Produkt i këtij mentaliteti është mosbesimi në kapacitetin nxënës, mosndërhyrja me stimulim, pritshmëria për të filluar më vonë. Ky nënvleftësim shkon paralel me të drejtat më të pakta që u njihen të miturve.

- *Lënia e zhvillimit gjuhësor e kognitiv në spontaneitetin e vet*. Ndërkohë që për ndikimin në fizikun e në aspektin psikosocial vlerësohen pozitivisht disa besime e praktika prindërore, prindërit nuk i kushtojnë shumë vëmendje zhvillimit gjuhësor e kognitiv. Disiplinat psikologjike kanë vënë në dukje hapësira pa fund për ndërhyrje në fushën e përvetësimit të gjuhës e të zhvillimit mendor, të cilat duket se në familje nuk njihen.

- *Ringjallja e praktikave tradicionale për lindjet*. Prirja që të pakësohet numri i lindjeve me asistencë për shkak të tranzicionit në shërbimin shënetësor e të izolimit rural, ka aktivizuar shumë praktika të lindjeve me asistencë popullore.

- *Mungesat e informacionit për çështjet e edukimit*. Një faktor i rëndësishëm është mungesa e dijes dhe e informacionit shkencor për rritjen dhe edukimin e fëmijëve nga ana e prindërve dhe e të tjerëve. Ky informacion që posedohet në nivele të caktuara nuk shkon te ata që kanë nevojë për të. Në këto kushte është gjallëruar veprimi i besimeve dhe i praktikave popullore që u sugjerohen çifteve nga brezat e mëparshëm. Eksperiencat e familjes së origjinës mbulojnë pothuaj të gjitha tematikat kryesore të mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve: ushqyerjen, fjetjen, kujdesin për stimulimin emocional, mendor, gjuhësor, fizik të fëmijës.

4.3. Elemente pozitive të ndërhyrjes institucionale

- *Ulja e vdekshmërisë së nënës, foshnjës dhe fëmijëve nën 5 vjeç*. Ulja e vdekshmërisë është rezultat i përmirësimit të strukturës së ushqyerjes në dekadën e fundit (hyrjes së ushqimeve të reja dhe shtimit të ushqimeve me bazë qumështi e mishi), vëmendjes më të madhe të institucioneve ndaj mortalitetit, mbulesës më të mirë vaksinale, etj.

- *Mbulesa e lartë vaksinale*. Efektet e mbulimit të mirë vaksinal shihen në uljen e vdekshmërisë, gjë që përbën shembullin më të mirë të efikasitetit të politikës mjekësore në veprim.

- *Shtimi i institucioneve që merren me fëmijët me probleme*. Vëmendja më e madhe e treguar ndaj kategorive të fëmijëve me probleme shihet si një përpjekje për t'iu përgjigjur nevojave të reja që lindin dhe si një elemnet i ri i kulturës sonë qytetare.

- *Inicimi i modeleve të reja të trajtimit institucional të fëmijëve me probleme*. Karakteri tradicional i shërbimeve ndaj fëmijëve në nevojë duket se po zbutet me inicimin e modeleve alternative, gjë që pasuron edhe skemat me të cilat ofrohen shërbimet.

- *Plotësimi i kuadrit ligjor*. Miratimi i shumicës së ligjeve që lidhen me nevojat e fëmijëve daton në dekadën e fundit dhe mund të thuhet se është përgatitur terreni që ato të kompaktësohen e të harmonizohen, gjë që pikaset në iniciativën për hartimin e strategjisë për fëmijët.

- *Përpjekja për të formuar netëorkun për fëmijët*. Krijimi i Aleancës për Fëmijët shënon një nga kulmet e përpjekjeve për të institucionalizuar bashkëpunimin e forcave të interesuara në punën për fëmijët, gjë që shihet si një element me perspektivë.

4.4. Elemente problematike të ndërhyrjes institucionale

- *Rënia e ndjeshme e frekuentimit të kopshteve*. Tranzicioni drejt demokracisë në dekadën e fundit me problemet e privatizimit, të lëvizjes së brendshme të popullsisë, etj., u shoqërua me pakësimin e kopshteve e të fëmijëve që i frekuentojnë ato. Kjo dukuri e pakënaqshme duket se po vlerësohet nga strategjia kombëtare për fëmijët.

- *Mungesat, fragmentarizmi, mosharmonizimi i ligjeve ekzistuese*. Këto konsiderohen pengesa të rëndësishme në rrugën drejt intensifikimit të përpjekjeve për një fëmijëri të mbrojtur e zhvilluese.

- *Kushtet e papërshtatshme të godinave të edukimit*. Godinat e institucioneve parashkollore janë në përgjithësi të vjetra dhe nuk u përgjigjen nevojave për qëndrim të sigurt, për kushte higjienike, për hapësira sociale, për respektim të privasisë dhe për aktivitet. Pa përmirësimin e këtyre kushteve zor se realizohen objektivat strategjike dhe politikat e shpallura.

- *Mungesat e bazës didaktike*. Baza aktuale didaktike e kopshteve konsiderohet e mangët, e vjetër, jofunksionale, ka karakter dekorativ dhe përmirësimet në të kërkojnë ndërhyrje të shpejta.

- *Programet tradicionale të edukimit parshkollor*. Sistemi ekzistues i çerdhes dhe i arsimit parashkollor perceptohet pozitivisht nga shumica e prindërve, por ata e shohin atë më shumë si institucion që e mban të sigurtë fëmijën ndërkohë që nëna merret me punë. Cilësia e edukatës parashkollore është shpesh shumë e diskutueshme. Më parë kopshti konceptohej jo si një institucion për të zhvilluar fëmijën, por si institucion për të shtuar produktivitetin e gruas si forcë punonjëse, ndërsa sot ai vijon të jetë institucioni mbajtës i fëmijëve për t'u çliruar prindërve të tyre kohë e për t'i përgatitur fëmijët për shkollë.

- *Mungesat në kualifikimin e edukatoreve*. Me përjashtime të pjesshme sistemi i kualifikimit të edukatoreve duket se nuk u përgjigjet kërkesave për një edukim parashkollor modern.

- *Pozita pasive si objekt e fëmijëve në edukim*. Paralel me nënvleftësimin e kapacitetit të të miturve dhe me pozitën e të miturve në familje vjen për fat të keq edhe trajtimi i fëmijëve si objekte të edukimit në institucionet e arsimit parashkollor. Për fat të mirë ekzistojnë edhe modelet përkatëse për ta bërë këtë gjë: Montessori, Step by Step, Frëbel, etj.

- *Shpërndarja e zhbalancuar e shërbimeve për fëmijët*. Mbulimi më i mirë gjeogafik me shërbime dhe ofrimi i shërbimeve përkujdesëse me të njëjtën cilësi duket se do të dojë më shumë vëmendje.

- *Kapaciteti i ulët i institucioneve për të përballuar kërkesën e lartë për shërbime*. Krahas grupeve tradicionale me prekshmëri të lartë si jetimët dhe handikapatët, ka mjaft të dhëna se po lindin grupe të reja fëmijësh në rrezik: fëmijët e braktisur, lypësit, fëmijët që jetojnë në familje të varfëra, fëmijët me një prind, fëmijët viktima të ngujimit nga gjakmarrja, fëmijët ilegjitimë, fëmijët që shfrytëzohen, etj. Këta nuk e kanë gjetur ende vendin në skemat e kujdesit publik dhe priten veprime në favor të trajtimit të tyre.

- *Mosharmonizimi i veprimtarisë së OJQ-ve*. Kapaciteti që ka ky sektor për të ndikuar në situatën e fëmijërisë së hershme duket se nuk vlerësohet objektivisht. Sektori

joqeveritar, ndërkombëtar e lokal, duket se është duke investuar mjaft, por ky investim shkon i paorkestruar dhe i pandihmuar për t'u bërë aty ku duhet.

- *Mungesa e mjediseve publike të pushimit e të argëtimit të fëmijëve*. Mjediset që ekzistonin dikur janë dëmtuar, kanë ndërruar pronësi, ose braktisur. Fëmijët në qytete zor se kanë mjedise të tilla të sigurta dhe zhvilluese.

Mungesat në kulturën e prindërimit. Të rinjtë martohen pa ditur pothuajse asgjë për prindërimin. Në punën tejet komplekse të prindërimit ata janë lënë vetëm dhe të pambështetur. Ata detyrohen t'u kthehen praktikave popullore e eksperiencës personale të mësimeve nga pësimet.

5. Rekomandime

5.1. Rekomandime për formulimin e një politike të re

Për Fëmijërinë e Hershme nevojitet të hartohet një politikë e re që të bazohet në parime të reja, të njohura por të pavlerësuara. Duke marrë shkas nga gjetjet e këtij studimi, më kryesoret e këtyre parimeve mund të konsiderohen:

- Instalimi i një Programi më vete për ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme.
- Integrimi i Programit të Fëmijërisë së Hershme me Programin e Gruas dhe të Familjes.
- Programi i Fëmijërisë së Hershme duhet të ketë fokus mbi kategoritë e fëmijëve dhe të familjeve më nevojtare.
- Programit i Fëmijërisë së Hershme duhet të kombinojë nevojat e mbijetesës me nevojat e zhvillimit.
- Programi i Fëmijërisë së Hershme duhet të fokusojë diskriminimin e të miturit në përgjithësi, diskriminimin gjinor në veçanti, si dhe çështjen e të drejtave të fëmijëve si prioritete.
- Programi i Fëmijërisë së Hershme duhet të integrohet me programe të tjera si: edukimi ushqimor, edukimi shëndetësor, planifikimi familjar, edukimi për paqe, etj.
- Programi i Fëmijërisë së Hershme kërkon pjesëmarrje më e gjerë në planifikim si dhe në zbatimin e iniciativave.
- Programi i Fëmijërisë së Hershme duhet të shpallë dhe të garantojë barazi në cilësinë e shërbimeve me gjeografi të ndryshme
- Programi i Fëmijërsië së Hershme duhet të sigurojë një koordinim të aktiviteteve të institucioneve publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime për fëmijët e kësaj moshe

5.2. Rekomandime në fusha specifike

5.2.1. Avokatia

Shqetësimet për statusin e fëmijëve u duhen ekspozuar audiencave më të gjera, përfshirë politikëbërësit, në nivele të larta të qeverisë, të të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, dhe të OJQ-ve lokale. Politikëbërësit kanë nevojë të kuptojnë dhe të veprojnë në favor të hartimit të ligjeve të reja e të përmirësimit të atyre që ekzistojnë, të

harmonizojnë kuadrin ligjor e të edukojnë administratën me frymën e ligjit. Organizatat ndërkombëtare kanë nevojë të dinë se ç'bën secili nga aktorët në fushë dhe të forcojë bshkëpunimin me ta duke formuar rrjete. OJQ-të lokale është nevoja të përdorin ekspertizën e tyre me qëllim që ofrojnë projekte që u përgjigjen nevojave të konteksteve të ndryshme.

Programi i Fëmijërisë së Hershme kërkon ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e prindërve, të komuniteteve, institucioneve dhe të medias. Ndërtimi i një filozofie të re për pozitën e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç dhe orientimi drejt fëmijëve kërkon që qytetarët, komunitetet, institucionet, të njohin situatën reale të jeës së fëmijëve të kësaj moshe në Shqipëri. Në këtë mes nevojiten fushata të rëndësishme sensibilizuese ku të orkestrohen të gjitha mjetet e mundshme: TV, radio, gazetat, botimet e të gjitha formateve. Vetëm fushatat agresive mund të arrijnë të ndërgjegjësojnë njerëzit të cilët merren me varfërinë e tyre, kanë mungesë kohe ose nuk dinë se si. Vetëm këto fushata mund të ushtrojnë presion edhe mbi vetë punën rutinore.

5.2.2. Edukimi

Prioritet i dorës së parë është edukimi i të gjithë atyre që merren me Fëmijërinë e Hershme. Prindërit dhe kujdestarët e tjerë të fëmijëve, edukatoret e kopshteve dhe çerdheve, punonjësit e intitucioneve shëndetsore dhe të përkujdesjes sociale që merren me fëmijët e kësaj grupmoshe kanë nevojë para së gjithash për informacione dhe dije shkencore. Kjo do ta skualifikonte pjesën demode të besimeve dhe të praktikave të mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve. Kjo është veçmas e rëndësishme për banorët dhe punonjësit e institucioneve të zonave të largëta e rurale. Format e edukimit mund të jenë: trainimet, botimet (botim i një serie komprehensive librash lidhur me fëmijërinë e hershme, botim fletëpalosjesh), emisione televizive dhe radiofonike duke përfshirë këtu sidomos radiot dhe televizionet lokale, cikle shkrimesh në median e shkruar etj. Nga studim del e nevojshme, që duke patur parasysh profilin e atyre që kujdesen për fëmijët, të adresohet tematika e mëposhtme: fazat e zhvillimit prenatal, faktorët që mund të dëmtojnë këtë zhvillim dhe kujdesi përkatës;. zhvillimet psikofizike të moshës së foshnjërisë dhe të moshës parashkollore; rëndësia e moshë së hershme në zhvillimin e mëvonshëm të individit; mënyrat efektive të ushqyerjes së gruas shtatzanë, të ushqyerjes së fëmijës me gji dhe ushqime solide; mënyrat efektive të komunikimit dhe disiplinimit të fëmijëve, probleme të formimit të roleve gjinore; mënyra të stimulimit të të mësuarit aktiv në këtë moshë etj.

5.2.3. Ligjshmëria

Kërkohet mbulim ligjor për të plotësuar mungesat ligjore, për të përmirësuar ligjet e vendimet ekzistuese, për të harmonizuar aktet legjislative e nënligjore. Siç është përmendur ligjet pritet t'u hapin qytetarëve rrugën për të përfituar shërbimet që ofrohen. Ndër veprimet më të shpejta do të ishin ndërhyrjet në ligjin për adaptimin, në kodin e familjes, në njohjen e kujdestarisë.

Modeli i financimeve të shërbimeve për fëmijët bazohet në modelin e një dekade më parë. Paketa të caktuara ligjore ose dokumente të tjera të përshtatshme lypset të përshkruajnë mënyrën si financohen nevojat e fëmijëve të kësaj moshe: sa nga shteti, sa nga vetë individët, sa nga donatorët, sa mbulohen vullnetarisht.

Përmirësimet ligjore nuk do të ishin të mjaftueshme për ta përmirësaur situatën pa garantimin e njohjes së ligjeve nga e gjithë administrata që merret me fëmijët e moshës së studimit.

5.2.4. Zhvillimi i kurrikulave dhe materialeve

Edukimi parashkollor publik në tërësi duket se është vënë në siklet për shkak të filozofive të përparuara ku mbështetet edukimi parashkollor privat i disa OJQ-ve si dhe i disa kopshteve publike. Ankesat si nga brenda ashtu edhe nga jashtë këtij sistemi, si nga qytetarët ashtu edhe nga specialistët e universiteteve shtrojnë nevojën e ndërtimit dhe të përmirësimit të kurrikulave ekzistuese dhe të materialeve përkatëse. Në këtë kontekst është e nevojshme:

- Të rindërtohen programet mësimore në shkollat e larta dhe në shkollat e mesme pedagogjike që përgatisin edukatore mbi bazë e një filozofie të re të mësidhënies në kopshte
- Të rindërtohen programet e mësimdhënies në kopshte dhe çerdhe në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me formimin që marrin edukatoret në shkollat pedagogjike dhe universitete
- Të zgjerohet hapsira e njohurive dhe shprehive për shëndetin riprodhues në programet e shkollës tetëvjeçare dhe të mesme
- Futja e njohurive për prindërimin në programet e shkollës së mesme

Në nivel kombëtar duket se ka ardhur koha për të krijuar një ent teknik kompetent (rrjet agjensish dhe njerëzish) të aftë për të mbështetur nevojat për trajnime e publikime.

5.2.5 Infrastuktura e institucioneve të mirërritjes, edukimit dhe përkujdesjes sociale

Në këtë kontekst është e domosdoshme të bëhet*:*

- rikonstruktimi godinat e kopshteve dhe çerdheve ekzistuese pasi në shumë prej tyre shëndeti fizik dhe mendor i fëmijëve është i rrezikuar seriozisht
- pajisja me bazë didaktike
- rimobilimi i institucioneve ekzistuese
- ndërtimi i godinave të reja për kopshte, çerdhe, shërbime sociale me qëllim që të reduktohet mbingarkesa e tyre aktuale
- ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijët e kësaj grupmoshe duke e shoqëruar këtë me kuadrin përkatës ligjor të funksionimit dhe mirëmbajtes së tyre

5.2.6. Studimet

Ndërtimi i politikave, modifikimi i tyre, programimi dhe zbatimi i projekteve në dobi të fëmijërisë së hershme kërkon studime të mëtejshme të thelluara në fusha specifike të besimeve dhe praktikave të ritjes dhe edukimit të fëmijërisë së hershme në sistemin familjar dhe institucional.